

Prof. dr. Mehmet RUKIQI

AZEM GALICA NË TRADITËN POETIKE POPULLORE

Më 15 korrik 2004, u mbushën 80 vjet prej
Mrënies heroike të Azem Galicës.

Azem Galica ishte luftëtari më i madh i kohës së
tij, që mbahet mend në Drenicë e më gjerë, kundër
okupatorëve të tokës shqiptare. Krijimtaria poetike
popullore, me Azem Galicën protagonist kryesor,
spikat ndër format më të larta të përvetësimit estetik
të realitetit. Është edhe kjo një dëshmi se poetika
dhe historia shkojnë paralel. "Janë bashkudhëtarë
shumë të afërm e të pandarë"¹ Aristoteli thoshte:
"Derisa historia flet për të veçantën, poezia flet për të
përgjithshmen dhe, në shumë raste, del si dituri më
e thellë e më serioze se historia".² Azem Galica u bë
frymëzues në krijimtarinë e shumë gjinive e llojeve të
artit gojor e letrar. Përherë mbeti simbol i sakrificës
gjithëkombëtare. Azemi u vendos në piedestalin e të
mirës etike dhe të bukurës e të madhërishmes estetike
për trimëri e për luftën e drejtë kushtuar mbrojtjes
së sovranitetit të atdheut e të popullit të vet. Me

1. Profesor Qemal Haxhihasani, Tregime popullore rreth periudhës së Skënderbeut, Studime filologjike, nr. 4, Tiranë, 1976, f.39-51.
2. Dr. Ilir Yzeiri, Poetika nga Aristoteli e deri te Natali Sarrot, Tiranë, 2000, f. 9.

pushkë në dorë demonstroi artin e luftës çlirimtare. Krijuesit popullor, bashkëkohës e bashkëluftëtar, si: Abdyl Istogu, Ahmet Buliqi, Ajete Shaqiri, Dervish Gogjuli, Dush Buliqi, Hafëz Mehmet Aliqi – Hoxhë Bajska, Hazir Rama, Jonuz Rukiqi, Jetullah Buliqi, Kamer Llausha, Osman Kryshecfi, Rushit Galica, Vesel Galica, Xhemë Tërnafcë e Zekë Fazlia krijuan dhe bartën një fond të çmueshëm poetik, në prozë e poezi, me tema nga jeta dhe veprimtaria luftarake e Azem Galicës. Kur përmenden: Hasan Prishtina, për dituri; Tahir Berisha, për mençuri; e Azem Galica për trimëri; duhet të ngritemi në këmbë”.³

Azem Galica (1889-1924), u lind në Galicë. Rrjedh prej një familje të varfër. Babai, Bejtë Galica, dallohej ndër trimat e kohës së vet. Dha jetën në një betejë me ushtrinë osmane, afër Deviqit, më 1903. Nëna, Sherife Galica, ishte bija e Kurt Selacit.

Nga kaçakët e bashkëluftarët e Azemit, në poetikën popullore, më të dalluarit janë: Abaz Kurrumeli, Adem Miftari, Bajram Tërnafcë, Bekë Galica, Çun Radisheva, Dan Deroci, Dan Radisheva, Emin Lati, Fazli Berani, Fekë Rakinica, Hajrë Prokshi, Halil Sejdia, Halit Bajrami, Hasan Lahu, Hazir Rama, Isë Koshutani, Jashar Durmishi, Jetullah Kopriva, Jetullah Rexhiqi, Kamer Loshi, Lutë Gllanasella, Mehmet Delia, Metë Halili, Murat Kameri, Murat Loshi, Mursel Ahmeti, Nakë Berisha, Qerim Shashi, Rexhë Halili, Rrukë Qubreli, Sadik Luboveci, Sahit Halili, Salih Rakinica, Sinan Çitaku, Shaban Llausha, Shaban Mangjolli, Shaqir Smaka, Shote Galica, Haxhë Abazi, Xheladin Lubaveci, Xhemë Tërnafcë, Zenel Baica, Zenel Suhogërlla, e Zenel Ujkani, nga Drenica. Përtej

3. Rrahim Bujupi, tregimtar popullor nga Arllati, Drenicë.

Drenicës përmenden: Azem Gjaka, Behë Mihaliqi, Bel Popova, Hys Popova, Hysen Boshkoviqi, Ilaz Raçaku, Ker Sadribardhi, Lan Ozdrini, Mark Mateja, Mehmet Konjuhi, Metë Ymeri, Ramë Alia, Sadik Rama, Salih Shabani e Shyt Bajçinofci. Nga jatakët më të dalluarit ishin: Abit Lupçi, Arif Lisica, Beqë Istogu, Brahim Hadaku, Dibran Ukshini, Fazli Brahimi, Fetah Bylykbashi, Hajdin Rraci, Hasan Veliqi, Hysen Qirezi, Islam Plaqiqi, Istref Smakiqi, Liman Buliqi, Nazif Jaha, Rexhep Aga, Smajl Buliqi, Smajl Radisheva, Shaban Çitaku, Shaban Haxhija, Shaban Polluzha, njëherit edhe bashkëpunëtor i shquar ilegal i Azemit; Sherif Gogjuli, Tahir Bardiqi, Ymer Tushila, Zenel Vitaku, Zenel Tema e Zenë Gllareva.

Këshilltarë e përkrahës më të spikatur të Azem Galicës e të Lëvizjes Kaçake ishin: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Hoxhë Kadrija, Bedri Pejani, Luigj Gurakuqi, Ramadan Shabani e Tahir Berisha.

Luftën e parë kundër okupatorit serb, sipas tregimtarëve popullorë, Azem Galica e zhvillon në mars të vitit 1913. Xhandarët e rrethojnë në kullën e Musli Mikushnicës. Vriten tre prej tyre, po edhe Dan Radisheva, i vëllai i Shotës. Azemi plagoset në dorë dhe, për herë të parë e të fundit kapet nga armiqtë. Një vit e vuan në burgun e Pozharevcit. Më 1915, Serbinë dhe Kosovën nën okupimin e saj i sulmon Austro-Hungaria. Ndiqen kaçakët si "njerëz të rrezikshëm". Më 6 mars 1917, në Kullë të Sefer Smakiqit, në Obri të Poshtme, Azemi lufton me forca të xhandarmërisë bullgare. Me te ishin vetëm Shota dhe i vëllai Ademi. Të dy vëllezërit plagosen, pasi i lënë disa armiqë të vrarë. Po në këtë vit, në male të Radishevës, bashkohen me Çetën Kaçake të Shaqir Smakës. Në

Bajë rrethohen nga xhandarmëria austriake. Ndër të tjerë, mbetet i vrarë edhe Shaqir Smaka, komandant i çetave kaçake të Drenicës Veriore. Tani Azemi, në moshën 28 vjeçare, mbetet në vend të Shaqirit. Në luftën që zhvillohet në Kllodernicë, nga Kulla e Sali Bekës, mbesin të vrarë 8 xhandarë. Për hakmarrje, në malin Gamna të Galicës, xhandarët i pushkatojnë dy vëllazërit e Azemit, Seferin e Zenelin.

“Në pranverë të vitit 1918, pas betejave të pandërprera në Pridvoricë të Koloshinit, takohen Azemi e Kostë Vojvoda – Peqanci. Lidhet një “marrëvjeshe” se “pas çlirimit nga Austro-Hungaria, aty ku ka më shumë shqiptarë, kryetari do të jetë shqiptar. Shkollat do të jenë në gjuhën shqipe. Bile edhe Kosova do të jetë e pavarur”. Lidhet “besë” për “luftë të përbashkët”.

Ishte fundi i Luftës së Parë Botërore. Më 15 tetor, kah ora 4 pas dite, në Mitrovicë hyjnë ushtria franceze e serbe. Vjen Azem Galica me afër 1000 ushtarë austro hungarezë të zënë robë në mes të Pejës e Runikut. Komandanti francez, gjenerali Bashle, në sallën e Bashkisë Komunale i organizon pritje solemne. Mban një fjalim përshëndetës për Azemin dhe popullin shqiptar. I jep një shpatë të oficerëve, që dhurohej vetëm për heronjtë e luftës. Njëri nga serbët e pranishëm, Azemit ia përcolli edhe ‘urdhërin e krajlit’, se: “Azem Galica, nëse e njeh Serbinë si shtet, do të jetë vojvodë i Kosovës”. Azemi i përgjigjet: “Ne kurrkënd nuk e njohim si shtet përveç Kosovës së pavarur nga Serbia dhe flamurin shqiptar”. Ndërkohë, nga Selaniku këthehet Milan Nediqi. Posa hyn në Mitrovicë, e ndërron Ibrahim Devën, kryetar i Rrethit dhe, në vend të tij, e vendos Jovo Kotorrin.

Azemi, vetë i shtati, i hyn në zyre dhe pasi ia jep një shuplakë të nxehtë, i thotë: "Nëse Ibrahim brenda 24 orëve s'këthehet në vendin e vet të punës, unë do t'u shpall luftë". Niset për Pejë, ku së bashku me mijëra shqiptarë, e ngrisin flamurin kombëtar. Këtë hap e kundërshton "besëlidhësi", Kostë Vojvoda, antishqiptari më i tërbuar".⁴

Lufta e parë, pas "marrëveshjes", fillon në Suhogërllë. Vritet Rexhep Haliti, i vëllai i Shotës dhe Vuçina i Radishevës, ndihmësvojvodë. Prej kësaj lufte, Çetës së Azemit, vetëm nga fshatrat e Drenicës veriore, i bashkohen mbi 200 veta. Nga ana tjetër, rivendoset regjimi serb edhe më i egër. Përfaqësuesit më të theksuar të këtij regjimi, nëpër krijimet popullore, janë krajl Aleksandra, e kryeministër Nikolla Pashiqi; naçallnikët, si Cvetko Stamenkoviqi për Vushtrri, Angjelko Neshiqi për Drenicë, Radisav Nekiqi për Mitrovicë, Miliç Kërsta për Pejë e Istog etj. "Nikolla Pashiqi, edhe në poetikën popullore, del si fytyrë më e urrejtur, si hartues i politikës çfarosëse të një populli dhe si mashtrues i zellshëm i shqiptarëve të mashtruar. Shovinistët serbë i këshillonte: 'Gjeni sa më shumë munafikë shqiptarë. Merrni me të mirë e rrihni krahëve. I lavdëroni para syve dhe u jepni armë e grada të thata, se ata tani do të vrajnë vëllauvëllanë. Veproni sipas parimeve "përçaj e sundo", "gjuaj gurin e fsheh dorën", "vraj natën e qaj ditën". Ushqehet në kuzhinën e gënjeshtreve në Moskë".⁵

Mulla Ibrahim Palaci, atdhetar i shquar, paska

4. Hafëz Mehmet Aliqi – Hoxhë Bajaska (1877-1985), tregime nga Mitrovica.

5. Dr. Mehmet Rukiqi, Krijues dhe bartës të tregimeve popullore në Drenicë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1998, f. 124.

thënë: "Kur të bani amin, lutnu: "O Zot na shpëto prej sherrit të Rusisë e prej rrenëve të Serbisë". Përmenden edhe agjentë, që ia ndriçonin rrugën armikut për të bërë krime, si prijsë të tragjedisë së popullit të vet. Në një anekdotë thuhet: "Zenel Çausi i thotë Shote Galicës: "Gjynah asht me bajtë grueja tesha të burrave"! "Paj, edhe ti, bre zotni çaus, kishe ba ma sevapë edhe ishe dokë fortë ma i mirë me i pasë veshë teshat e grave"! – i tha Shota".⁶

"Azem Galica prej shkurtit të vitit 1919, konsiderohej si komandant i përgjithshëm i Lëvizjes Kaçake të Kosovës. Tani luante edhe rol të komandantit për edukatë moralo-politike".⁷ Kaçakëve shpesh u thoshte: "Për njeriun që ka arritur të bëhet i njohur dhe përfaqësues i ndonjë lufte për çlirim nga i huaji, mjafton një fjalë pa vend, një akuzë pa bazë apo një vepër kriminale antinjerëzore dhe të bie poshtë. Mjafton të gënjejë vetëm një herë e të mos i besohet dot asnjëherë".⁸ Azemi, nga kjo pozitë, ishte kundër demagogëve që flasin shumë, për të mos thënë asgjë; që shprehin mendime me fjali të stërgjatura, të lodhshme e të ndërlikuara; që u largohen fjalive të thjeshta për të mos u dalur rrenët në fushë". Si gëzimin ashtu edhe hidhërimin i shprehte brenda kufijëve të tolerancës. "Asnjë kaçak nuk i ka shpëtuar pa ia njohur biografinë e tij, pa e pyetur "mos je në hasmëri me dikë", "mos ke inat ndaj kujdoqoftë", sepse duke e shfrytësuar për të keq detyrën e kaçakut, duke vrrarë e plagosur njerëz jashtë frontit të

6. Po aty.

7. Dr. Limon Rushiti, Lëvizja Kaçake në Kosovë (1918-1928), Institui i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1981, f. 107.

8. Selim Spahia, veteran i arsimit dhe tregimtar popullor nga Vitaku, Drenicë.

luftës, ia merr fytyrën krejt Lëvizjes Kaçake.⁹ “Edhe Lëvizja Kaçake e drejtuesit e saj, patën probleme me kaçakët e rrejshëm. Ata kishin ardhur në çeta si dezertues ushtarakë, vrasës, me motive politike ose për hakmarrje. Ishin cuba e hajna. Ishin “kaçakë” të shtetit, të paguar si “kaçakët” e Ceroviqit. Mbanin armë dhe leje të veçanta. Minonin Lëvizjen. Ishin të padëshiruar nga çetat dhe jatakët”.¹⁰

Sipas rapsodëve popullorë:

*“Azem Bejta çka paska thanë,
Burrë i meçum kush t’donë me kanë,
Punve t’kqia hyzmet s’u ban,
Se vjen nji ditë e u bjen pishman”.*¹¹

Azemi shpesh i theksonte pasojat që, deri këtu, na i solli regjimi serb: “Serbia në Kosovë e qiti farën më të keqe ruse e sllave. Kur mbiu kjo farë na i solli të gjitha të zezat në ne e për ne. Mbiu agresiviteti e arroganca, cinizmi e çoroditja, degjenerimi e demagogjia, dyfytyrësia e dhuna, edukimi i keqe euforia, falsifikimi e gënjeshtria, hajnia e hilja, hipokrizia e inati, intrigat e konfliktet, politika djallëzore e paturpësia, urrejtja e gjelozia”.

Më 13 prill 1919 lufton kundër ushtrisë serbe në Sferkë të Gashit. Lufta zgjerohet deri në Cerovikë. Vriten 6 xhandarë të stacionit të Rahovecit. Naçallniku i Zveçanit, ndër të tjera, shkruante: “Azem Bejta tani

9. Xhemë Tërnafci, bashkëlufëtari i Azem Galicës.

10. Dr. Limon Rushiti, vep.e cit.

11. Vargjet në këtë punim, janë shkëputur prej këngës “Azem Bejta”, të krijuar nga Dervish Goxhuli (1870-1937), e botuar në disa përmbledhje në këngët epiko-historike, e në rastin tone, e interpretuar nga Brahim Rexha i Kopiliçit të Epërm.

u bë vojvodë e prijs i Lëvizjes Shqiptare në Drenicë, në Dukagjin e Podrimë".¹² Më 28 prill të këtij viti, Azemi me çetën e tij prej 50 deri në 60 vetësh ndodhej në Radishevë. Rrethohen nga ushtria e Garnizonit të Mitrovicës, të prirë nga Kostë Vojvoda. Me artileri i rrafshojnë Radishevën e Suhogërellën. Pas një lufte tërë ditën, e lëshojnë Drenicën. Në Gjurgjevik, në Ujmir e në Siçevë qëndrojnë 15 ditë. U bashkohen Sadik Rama e Ramadan Shabani. Luftojnë në Gllarevë, Çabiq, Plloçicë e Kosmaç. Në mëngjesin e 5 majit i sulmon ushtria e Rahovecit me artileri. Lufta zgjat deri në mbrëmje. Fshatarët e Krejkovës u vijnë në ndihmë me bukë. Me 6 maj kalojnë në Obri të Poshtme. Nga Deviqi, kërcet topi. Granata e mbyl të riun Sylë Zhabota, djalë hasreti. Azemi me 30 kaçakë dalin në Shqipëri. Takohen me Hasan Prishtinën, me Bajram Currin e me shumë krerë që përkrahnin Lëvizjen Kaçake. Marrin udhëzime për të organizuar luftëra e plane strategjike.

Në janar të vitit 1920, në luftën që bëhet në Taraxhë, afër Vushtrrisë, nën drejtimin e Azem Gjakës dhe Ajet Dervinës, merr pjesë edhe Shota. Atë ditë, në vend të thirrjes: "O prite prite Azem Galicën", dëgjohet thirrja: "O prite prite Shote Galicën".¹³ Shote Galica edhe në poetikën popullore, është trimëresha më e madhe e kohës së vet. Hyri në histori si personalitet më i lartë. Shënoi një hap të madh e të jashtëzakonshëm në Lëvizjen Kaçake. Bëri një transformim të madh shoqëror. Krahas Luftës kundër rmikut, i dha grusht të fortë edhe prapambetorisë. I tregoi botës se po të

12. Dr. Limon Rushiti, vep. e cit.

13. Ajet Haxhiu, Shota dhe Azem Galica, Shtëpia Botuese "8 Nëntori". Tiranë 1976, f.9.

rrezikohej liria e atdheu, edhe nusja shqiptare din t'i kapë armët e të hudhet në luftë. Azem Galica, me të drejtat dhe me përkrahjen që ia dha bashkëshortes, ngriti edhe më lart famën e besës e të trimërisë së vet.

Ngjarja më e rëndësishme, që e përshton thujtë tërë krijimtarinë poetike, me temë nga heroizmi i Azem Galicës, është lufta përfundimtare në Galicë, më 15 korrik të vitit 1924. Kjo ngjarje, pasuroi në veçanti prozën dhe poezinë popullore. Nga krijues dhe bartës të thesarit poetik gojor, ndër të tjera, theksohet: Zhupani i Shkupit, më 13 e 14 korrik 1924, me 2000 ushtarë të armatosur e me gjashtë topa vjen në Mitrovicë. Më 15 korrik, ditën e tretë të Bajramit të Vogël, rrethohen tri fshatra të "Zonës së lirë": Galica, Lubaveci e Mikushnica:

*Komandirët e marojnë parullën,
Nimi vetë ia rrethojshin kullën.
Nimi tjerë krejt Galicën,
Pesqin vetë këtë Mikushnicën.
Mikushnicën me Lubavec,
Tri katune i rrethojshin krejt.*

Hasan Lahu i Galicës, ishte i pari që e hetoi rrethimin. Ai kishte fjetur në lëmë, duke e ruajtur një grumbull të drithit. Në dyer i trokasin një grup ushtarë, me fjalë të rënda, kërcënime e të shara në gjuhë serbe. Vrapon në drejtim të kullës, për t'i treguar Azemit se u rrethua. Pushkët e para zbrazen drejt në te, por shpëton. Me pushkët e dyta, afër Kullës, vritet Salih Xhemajli. Kërcet topi i parë, në drejtim të Prekazit, afër dy kilometra në perëndim. Vritet gruaja e Osman

Veliut. Topi i dytë ishte vendosur në Lubavec, i treti në Sukë të Galicës, i katëri në Dubofc, i pesti në Mikushnicë, dhe i gjashti te Mrizet e Mikushnicës. Përveç divizionit ushtarak të Zhupanit, me armatim më modern të kohës, marrnin pjesë edhe xhandarë e komandantë të stacioneve, thuajse nga të gjitha anët e Kosovës. Pat shumë serbë e malazezë civilë, po edhe ndonjë shqiptar. Në kullë, përveç Azemit e Shotës u gjetën edhe Hazir Rama, Hys Popova, Zenel Suhogërlla, Bajram Tërnafcu e Shaban Mangjollu.

Sipas këngës:

*Azem Bejta n'kam u çue,
Shokve t'vet iu ka kallxue,
Çonu vllazen se jem rrethtue.
Jem rrethue more vllazni,
Do t'marojnë sot robë e thmi.
Se s'a shaka me kit Serbi,
Ka ta ze s'e lësho pa e gri,
S'kursen gra as pleq as t'ri.*

Me gjëmimin e topit të parë, Azemi del prej kulle:

*Krisi topi na i ra zidit,
Po i bërtet Azemi Halitit.
Zo kut t'kam vlla Halit Bajrami,
Merrjau anën okolla gardhi.
Okolla gardhi e dil m'at anë,
Vet po u dal, kysmet, për mejdan.*

Fillon lufta grykë më grykë. Në oborr, Azemi e vret një kapiten. Shokët e Azemit i vrasin mbi 20 ushtarë. Vritet Hys Popova, luftëtar veteran. Shpërthejnë

rrethimin e parë të kullës dhe bashkohen me shokët e tjerë. Azemi, pas një lufte të Vrella e Galicës, del në malin Gamna. Shota, sipas porosisë së Azemit vrapon drejt britmës së grave e të fëmijëve. Kalojnë te Ura e Frashnit, në rrugën malore drejt Mikushnicës. Aty ndahen në dy grupe: Azemi me Hazir Ramën, Bajram Tërnafcin e Halil Galicën, anën e epërme të rrugës, ndërsa Sadik Luboveci, Halil Vërmica, Zenel Suhogërlla, Xheladin Luboveci e Murat Galica në anën e poshtme. Azemi me grupin e vet del përmbi shtëpi të Azem Mikushnicës. Grupi tjetër ndeshet me ushtri. Sadik Luboveci e Xhemë Tërnafci i vrainë 6 ushtarë. Në livadh të Jusuf Rexhës ndizet lufta ballë për ballë. Granata e një topi bie midis ushtarëve serbë, që ndihmoi shpërthimin e rrethimit tjetër. Azemi, posa del në qafë të Mikushnicës, në një sokak të ngushtë ndeshet me ushtri:

*Azem Bejta si kreshnik,
Po luftojke gryka, m'grykë.*

I vret 16 ushtarë e të tjerët marrin ikën. Aty, Azemi e merr plagën e parë. Plumbi i depërton prej anës së djathtë të gjoksit e në shpinë. Nëna e Hasan Mikushnicës ia bjen një kënatë ujë. Thonë se e ka pi në vend. Skajet e një peshqiri të dredhur, në formë lyktyre i fut në të dy vrimat e plagës, që të mbrohet nga gjakderdhja përbrenda. Afër mrizeve të Mikushnicës, vriten Bajram Tërnafci e Sadik Luboveci:

*Bajram Tërnafci çka paska thanë,
I thoni nanës mos t'um kan.
I thoni nanës most'um kan mue,*

*Shtatë herë veten e kam pague,
Azem Bejtes tuj nimue.*

Shokët e tjerë të Azemit teshen me një batalion ushtarë. Vriten: Halit Bajrami, Murat Luboveci e Kamer Xhema. Plagosen: Hazir Rama, Xheladin Luboveci, Xhemë Tërnafici, Halil Galica e Murat Galica. Bejta, nipi i vogël i Azemit 13 vjeçar, prej lodhjes mbetet i shtrirë. Xhema e Zenel Ujkani e bartin në shpinë. Pak përtej livadhit të Isuf Rexhës, bëhet gjakderdhja më e madhe. Aty kaçakët u ndeshën me dy kolona ushtarë, në të dy drejtimet të Galicës e të Prekazit. Plagoset Qerim Shashi, i Lubavecit që e zë një gropë e lufton aq rreptë, sa ushtria mendonte se është Azemi:

*Pa u provue nuk dihet trimi,
Shtatë po i vrajka ky Qerimi.*

U përpoqën ta zënë të gjallë, por kot. Ia qesin bombat dhe e vranë. "Në vendin ku ka luftuar Qerimi, është gjetur një zog mali i vranë dhe një gjarpër i këputur në tre vende".

Për Qerimin dhe lubavecasit, sipas kangës:

*Azem Bejta çka paska thanë,
Trimav' hakun mos me jau ngranë,
Lubaveci gjithmonë jan kanë.
Gjith jan kanë e kanë liftue,
gjithsaherë kur jam ngushtue,
Djemtë e Gashit m'kanë nimue.*

E shpërthejnë edhe këtë rrethim.

Krijuesi¹⁴ i kësaj kënge, Azemin me çetën e tij, në këtë betejë i nxjerr fitimtarë:

*Te Zhupani bërtet buria,
Hajdini lene, hiqnu tina.
Hiqnu tina u paska thanë,
Se t'shtat kralat me u çue n'kamë,
Azem Bejtën s'mujnë me zanë.
Nime koka qysh um kanë thanë
veçte Muja nat vakt n'koft kanë.*

Megjithatë, duke kaluar grykën e një përroi të vogël, drejt Galicës, ushtria, nga ky përrua, lëshojnë një breshëri plumbash. Azemi merr plagën e dytë vdekjeprurëse. Plumbi i armikut e qëllon në rreth të fishekëve. Paqeta me tre fishekë i depërton në mjedis e mbetet në vend. Kamer Llausha e kap në shpinë. Me të ishin Shaban Mangjulli e Halil Galica. Strehohen pas një bregu. E gjejnë një krua dhe, pasi pijnë ujë, me Azemin në shpinë dalin në livadhet e Beqiqit. Në oborr të shtëpisë së Lamit, marrin një kerrstinë të mbrame, një penë kije, një jorgan e një jastëk. Ngjiten në krye të Dubofcit, te Kroni i Ftoftë. Aty, pasi caktojnë rojet pinë ujë dhe i lajnë varrët. Shota me disa gra, shpërthejnë rrethimin drejt Kronit. I afrohet Azemit. Ia bën për hajr varrët atij dhe krejt shokëve. U jep gajret si më i miri burrë trim.

Posa dalin prej territorit të Galicës, ushtria e xhandarmëria s'i ndjek dot kaçakët, por shpërndahen nëpër fshatra për të bërë plojë. Zëra të tërbuar, me sharje e fyerje në gjuhë serbe, tmerronin më fort se krismët e armëve. Granata e plumba bijnë mbi tri

14. Dervish Gogjuli (1870-1938) nga Makërmali i Drenicës.

fshatra sikur breshëri. Prej 120 shtëpive vetëm ajo e Zenun Behramit të Mikushnicës mbetet e parrënuar. Flaka që delte prej shtëpive, koshave, hambareve, plemeve e stogjeve, dukej sikur e prekte qiellin. Britma e grave dhe e fëmijëve, ulurima e qenëve dhe e kafshëve që digjeshin për së gjalli, shtangonte zemrat e dëgjuesve të ambientit. Azemi, nëdonëse i plagosur rëndë, mori dylbitë dhe i shikoi fshatrat. Ofshani thellë: "Ah i mjeri unë për vëllazërit e mi". Për herë të parë, në fytyrën e tij u panë dy lotë, që rrodhën me shpejtësi, thuajse nxitonin për ta shuar flakën që i dilte "Arbërisë së Vogël".

Në mes të fshatit Galicë, në sheshin ku përpiqen tri rrugë, në aksionin e parë, pushkatohej 25 burra e një grua. Një grua tjetër digjet për së gjalli. "Në Mikushnicë, në lagjen e Manxhollëve, vritet një grue e re – nuse. Ajo ishte bija e Man Gradefcit të Brabaniqit. Mani paska thanë: "Jam i lumtur si ma bani Zoti nasip të jam baba i një dëshmoreje, që ra në luftën e Azem Galicës, kundër Serbisë.¹⁵ Deri në orën 8 pas dite, vetëm numri i të pushkatuarve arrin në 42 veta. S'dihet numri i të vvarëve dhe i të plagosurve përreth. Për krime u dalluan malazetët e Taraxhës, të Balincës, të Kralicës e të Mikushnicës. Brahim Galica, që kishte shpëtuar nga pushkatimi, tregonte: "Një cërnagor, në tesha civile, e bjen një fëmijë 12 vjeç para nesh, që ishim në varg për batare. Me duar të lidhne u munojshin m'e mëshefë. Po na hetoi. E kapi për krahu dhe i ra 6 herë allti".¹⁶ Ajete Shaqiri, nëna e atij fëmije, reja e Halit Bajramit tregonte: "Dola m'e lypë

15. Mulla Asllan ef. Murati, imam dhe kryetar i Bashkësisë Islame në Mitrovicë.

16. Januz Rukiqi, tregimtar dhe rapsod popullor nga Vërbofci.

djalit tim - Bajramin. Shkova n'kryq të udhëve, ku i kishin vra burrat. Ish kanë gjaku deri në zog të kamës. Gardhiqet e kallne prej zjarmit të pushkëve, ishin rambi ta. Shumë xhenaze ishin djegë. Djalit tim ia gjeta veç shejat – një mangë të mitanit edhe plisin e shpuen në nimdhetë vena. Trupi e teshat e tjera iu kishin djegë". Gati për të gjithë, hapet një varr i përbashkët në oborr të kullës së Azemit. "Informatave të rrejshme serbe se 'në Galicë u vranë 190 kaçakë', Ferat Draga u përgjigjet: 'atë ditë në Galicë ishin 19 kaçakë. Prej tyre u vranë 5. Të 185 të vrarët e tjerë, janë popullatë e pambrojtur.¹⁷

"Azem Galica i plagosur, me shokët që i mbetën, prej Kronit të Ftohtë kalojnë në 'Lugun e Madh' në mes të Krasaliqit e të Kozhicës. Pas qëndrimit 7 ditësh, nisen për Shqipëri. Azemin e vëjnë në një vig (lese) të thurur posaçërisht. Duke u zhdjergur përroit të Kozhicës, papritmas, takohen me Mehmet Konjuhlin e Shyt Bajqinofcin me 12 shokë. Mehmeti, posa e sheh Azemin të shtrirë, fillon të qajë sikur fëmijë. Azemi e qetëson me fjalët: 'S'jam fort i lig. Tash u bëmë 30 vetë. Nga një orë, sikur të më bartni në shpinë, do të hyjmë në Shqipni'.

Prej Kozhice, dalim në malin Shkozë të Mulla Bajram Vërbofcit, ku kalojnë një ditë. Shumë dashamirë të Azemit, shkojnë për t'u takuar me te për herë të fundit. Shumë përqafile e lotë u derdhën mbi te. Natën e 23 korrikut e lëshojmë Vërbofcin. Në Makërmal, në livadhe të Gogjulëve, ia qesin atin e strehuar në ahrin e Kullës së Shaban Polluzhës. Në Malet e Çabiçit pushuam tërë ditën. Azemi dukej se ishte më mirë. Me ndihmën e shokëve, i hyp atit.

17. Dr. Limon Rushiti, vep. e cit.

Ati, sikur u gëzua që në shalën e tij edhe një herë u ul Azem Galica. Ngritet në këmbë të mbrama. Por, i shkreti at, s'dijti se Azemit, me këtë rast iu këput edhe ajo pjesë e kurrizit që ende e mbante të gjallë. Për herë të parë dëgjohet edhe ofshama e tij 'Oh Nanë! E shtrijnë prapë në vig. Kërkon t'ia ndezin një cigare. Gacën e ngritte lart, Vërejtjes: "Ruaje gacën o Azem se po na diktojnë xhandarët", iu përgjegj: "Sa të jeni me Lokën kurrë mos keni frikë".

Në Gjurgjevik të Madh hyjmë te njani. Ish kanë shtëpi e madhe me mbi 60 anëtarë familje e me fe katolike. Na sollën për të ngrënë e pirë çka pat, por Azemi s'përbiu asgjë. Vijnë Metë Ymeri e Bali Fazlia me dhjetë shokë. Së bashku dalim në mal ndërmjet Gllarevës e Përçevës.

Agon dita e 25 korrikut. Bagëtia u lëshuan malit. Dikush ia bjen Azemit një tas tambël, po as që e shikoi. Kah ora 6 e mëngjesit Azemi ishte në agoni. Shota ia mbante kryet në gjoks. Arrijnë sekondat e fundit të jetës së tij. Me një të ngritur lart të dy duarve, Azem Galica jep shpirt. Një shpirt i madh u nda prej një trupi vigan. Të gjithë mbetëm si të shtanguar për komandantin tonë. Heshtjen e varrit, prej disa minutash, e ndërpreu Shote Galica me fjalët: "O burra, Zoti ju lashtë shnosh për Azemin! Besoj se edhe ai neve, po edhe na atij do t'ia bëjmë hallall. Me vdekjen e Azemit s'do të thotë se e humbëm luftën. Do të luftojmë deri në fitore".

Tërë ditën i qëndruam pranë sikur rojë nderi. Në mbrëmje, duke vepruar sipas amanetit të tij se "gjenazen time mos të ma prek anmiku me dorë", se deri atë ditë kur të dihen eshtnat dhe varri im unë jam i gjallë', Halim Ngucati i Përçevës, na e gjen

një shpellë. Ai, me Zenel Suhogërellën, me Shaban Mangjollin e me Hamit Bajçinofcin e mbështjellën mirë me jorgan. Të gjithë u betuam se: "më parë do ta japim jetën se sa të tregojmë Shpellën e Azemit". Me një konop të gjatë dhe me shoka të lidhura varg, e lëshojnë shpellës teposhtë. Nja dhjetë minuta e kemi dëgjuar jehonën e zbritjes së Azemit në thellësi.

Po, po! Shkoi Azem Galica thellë, shumë thellë, në gjiun e Tokës Nanë, që ia kushtoi jetën".¹⁸

Këngën "Azem Bejta", e hartoi Dervish Gogjuli¹⁹ më 1925. Që nga mosha rinore shkonte nëpër oda e tubime. Mblodhi nektarin e mençurisë dhe të aftësisë krijuese popullore. Ishte gjeniu më i kompletuar i krijimtarisë poetike gojore në shekullin e tij. U takonte, thujse, të gjitha llojeve të prozës dhe poezisë. Krijoi dhe këndoi me lahutë për personalitete heroike, përveç Azem Galicës, edhe për Ahmet Delinë, Dan Derocin, Kamer Loshin, Lec Gradicën, Nak Berishën e Zenel Balcën. "Vargjet" nismëtare i skalit duke bërë vija në hirin e oxhakut të mullinit që e ruante. Këngët e tij i dallon shkurtësia pregnante e ndërtimit dramatik. Janë kaptinë e veçantë e artit poetik popullor më të angazhuar. Janë përherë të gjalla, të pandryshueshme e të papërsëritshme, me vlerë të veçantë estetike.

Këngën për Azem Galicën e kënduan pasardhësit e tij, deri në ditët e sotme. Kështu, në Arllat, Metë Bujupi; në Baicë të Helshanit, Liman Zariqi e Sejdi

18. Xhemë Tërnafici, i përmendur më parë.

19. Dr. Mehmet Rukiqi, Krijues dhe bartës të tregimeve popullore në Drenicë, Instituti Alabanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1998, f. 202.

Halimi; në Baicë të Kolshit, Halil e Tafil Krasniqi; në Bezhenik, Xhemail Bajraktari; në Brojë, Ibish Mulaku e Mehmet Mulaku; në Qubrel, Ajet Paliqi; në Gllanasellë, Halim Beqa e Daut Karaçica; në Glllogofc, Tahir Drenica; në Korroticë të Epërme, Selman Bala; në Kopiliq të Epërm, Brahim Rexha e Malë Syla; Në Kopiliq të Poshtëm, Rexhë Gashi; në Nekofc, Adil Dugolli; në Palac, Rrustë Kabashi; në Poklek, Hysen Gorani e Ramë, Halil e Hysen Cervadiku; në Qirez, Qazim Berishà; në Shtuticë, Selman Gashi; në Tërstenik, Cufë Kadishani, Habib Kukiqi e Haxhi Bajrami; në Vërbofc, Hamit e Januz Rukiqi, dhe vëllezërit Mustafa, Habibi e Hashim Shala.

Për Azem Galicën, jashtë Drenicës kënduan: Në Llapushë, Xhelir Islami i Turjakës e Hamëz Roda, Ali Paci e Bajram Sadiku, Salih e Feriz Krasniqi, Ali Krasniqi e Muhamet Bashota, Sefë Mleqani, me të bijtë Ymerin, Osmanin, Brahimin e Beqirin; Gani Maraliu e Sejdi Joviqi, Qerim Gashi e Isë Llapçeva, Halil Bytyçi e Naim Krasniqi; Në Llap e Gallup, Behë Canolli e Muharrem Gashi. Në Podrime, Rizah Bllaca me Osman e Rrahman Tafollin e me Hilmi Petreshticën; Në Rrafsh të Dukagjinit, Dervish Shaqa, Bajrush Doda, Lan Dobra, e Rizah Strellci; Në Gjakovë, Ymer Riza e Qamili i Vogël.

Këngët epiko-historike për Azem Galicën janë më tepër se art, janë shpirti i popullit.